



	Republika e Kosovës Republika Kosovo • Republic of Kosovo	
Institucioni i Avokatit të Popullit Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution		
Nr./Br./No. <u>1817/2017</u>		
Nr.i fqj/Br.str./Nr.pg. <u>01/12/17</u>		
Data/Datum/Date:		



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIM

A.nr. 238/2015
Hasibe Tortulla

lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prizren në lëndën
C.Nr.450/2009

Për: Z. Ymer Hoxha, Kryetar
Gjykata Themelore në Prizren

Prishtinë, më 1 dhjetor 2017

Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij rapporti është tërheqja e vëmendjes së Gjykatës Themelore në Prizren, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C.Nr.450/2009, pa vonesa të mëtutjeshme.
2. Ky rapport është i bazuar në ankesën individuale të znj. Hasibe Tortulla në tekstin e mëtejmë (*ankuesja*) e cila në këtë çështje juridike është palë ndërhyrëse dhe mbështetet në faktet dhe provat e ankueses, si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore për lëndën C.Nr.450/2009, që ka të bëjë me vërtetimin e pronësisë dhe dorëzimin e pronës se paluajtshme.

Baza ligjore

3. Sipas nenit 135, paragrafi 3 të Kushtetutës: “*Avokati i Popullit ka te drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore*”.
4. Po ashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16 paragrafi 8, përcakton se: “*Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme përfunksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përvçe rastit kur ka zvarritje të procedurave*”.

Përbledhja e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat me të cilat posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), mund të përblidhen si në vijim:

5. Lidhur me çështjen z. Qerime Elmazi-Hagjioglu në vitin 2000 kishte ushtruar padi përvërtetim pronësie dhe dorëzimin e paluajtshmerisë në ish Gjykatën Komunale në Prizren - tani Gjykata Themelore.
6. Më 23 nëntor 2004, Gjykata Komunale në Prizren, ka nxjerrë aktgjykim C.Nr. 200/2000, duke e aprovar kërkesëpadinë e znj. Hagjioglu, kundër te cilit është ushtruar ankesë në Gjykaten e Qarkut, nga përfaqësuesi i komunës dhe si dhe nga vet *ankuesja*.
7. Më 5 qershor 2006, Gjykata e Qarkut në Prizren, duke vendosur lidhur me ankesat kishte nxjerrë aktgjykim AC.Nr.228/2005, me ç' rast ka refuzuar ankesat e palëve ankuese, dhe kishte vërtetuar aktgjykimin C.Nr.200/2000 te Gjykatës Themelore, të datës 23 nëntor 2004.
8. Përfaqësuesi i komunës përmes Prokurorit te shtetit, brenda afatit ligjor, kishte ushtruar kërkesë për Mbrojtje te Ligjshmërisë në Gjykatën Supreme te Kosovës, kundër aktgjykimeve të lartpërmendura.
9. Më 13 shkurt 2007, Gjykata Supreme e Kosovës nxjerrë aktvendim MLC. Nr. 19/2006, i cili prishë aktgjykimet e Gjykatës Komunale dhe Gjykatës së Qarkut në Prizren, duke e kthyer çështjen në rigjykim.
10. Më 11 qershor 2008, Gjykata Komunale në Prizren, nxjerrë Aktgjykimin C.Nr. 181/2007, kundër te cilit *ankuesja*, ushtron ankesë në Gjykaten e Qarkut në Prizren.

11. Më 8 qershor 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren, nxjerrë aktvendim AC.Nr.508/2008, me të cilin aprovohet ankesa e *ankueses*, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
12. Më 7 maj 2015, *ankuesja* ka paraqitur ankesë në IAP kundër Gjykatës Themelore në Prizren, lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në lëndën C.nr.450/2009, që ka te bëjë me vërtetimin e pronësisë dhe dorëzimin e pronës se paluajtshme.
13. Më 30 korrik 2015, Avokati i Popullit, ka dërguar një letër kryetarit te Gjykatës Themelore në Prizren, duke kërkuar informata lidhur me çështjen e ngritur nga *ankuesja*.
14. Më 6 gusht 2015, Avokati i Popullit, pranoi përgjigje nga kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren me të cilën njofton se: “*Lënda deri më tani është caktuar 4 herë, mirëpo për shkak e objektive e njëjtë shtyrë dhe herën e fundit është caktuar për 24 gusht 2015, dhe shpresojmë që e njëjta do të procedohet deri në përfundimin e saj definitiv*”.
15. Më 25 shtator 2015, *ankuesja* ka informuar se seanca e datës 24 gusht 2015, nuk është mbajtur për shkak te mungesës së Avokatit Publik të komunës.
16. Më 28 janar 2016, Avokati i Popullit i dërgoj edhe një shkresë kryetarit te Gjykatës Themelore në Prizren, për te kërkuar informata, në lidhje me çështjen e parashtruar.
17. Më 3 shkurt 2016, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren me të cilën njofton se: “*Pas shikimit në shkresat e lëndës dhe bisedës me gjyqtaren e çështjes, është konstatuar se lidhur me këtë çështje janë mbajtur 16 seanca, mirëpo lënda nuk ka mundur të përfundojë sepse shumë here ka pasur pengesa objektive pasi paditësja kryesore ndodhet në Turqi, por përfundimisht janë bërë ekspertizat e nevojshme dhe e njëjta lëndë ndodhet para përfundimit ashtu që në bazë te orarit të punës lënda është caktuar me 22 shkurt 2016, dhe nëse nuk ka pengesa tjera objektive pritet që e njëjta te përfundojë*”.
18. Më 24 shkurt 2016, *ankuesja* ka njoftuar se seanca e datës 22 shkurt 2016, nuk është mbajtur, dhe se seanca e radhës është caktuar me 17 mars 2016.
19. Më 24 mars 2016, *ankuesja* ka njoftuar se është mbajtur seanca e caktuar më 17 mars 2016, dhe e se seanca e radhës është caktuar për datën 6 prill 2016.
20. Më pastaj, janë mbajtur edhe disa seanca: më 18 korrik 2016; 26 shtator 2016; dhe 20 tetor 2016.
21. Më 16 mars 2017, përfaqësuesja e IAP-së, ka biseduar me gjyqtaren e rastit, e cila ka pohuar se rr Ethanat e rastit janë të komplikuara, por që gjykata do të vazhdojë punën në zgjidhjen e rastit.
22. Më 28 gusht 2017, përfaqësuesja e IAP-it, ka biseduar me drejtorin e Kadastrit në Prizren, përkthazi me çështjen e *ankueses*. Sipas drejtorit të Kadastrit, kjo drejtori ka njoftuar Avokatin Publik i komunës se nëse vendimi nga Gjykata Supreme e Kosovës është i plotfuqishëm, atëherë Kadastri është i detyruar të bëjmë kthimin në gjendje të mëparshme të pronës. Ndërsa, kur vendimi nuk është i plotfuqishëm dhe lënda kthehet në rigjykim, regjistrimi i pronës bëhet vetëm me vendim të plotfuqishëm te gjykatës. Drejtori i

Kadastrit për më shumë ka njoftuar se në konsultim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK), si organ i shkallës se dytë, Kadastri obligohet që për ngastrat katastrale që janë objekt i një procesi gjyqësor, certifikatat pronësore t'i lëshon me vërejtje për të evitar tjetërsimin e tyre deri në një vendim tjetër të plotfuqishëm.

23. Më 29 gusht 2017, përfaqësuesja e IAP-it, ka biseduar me gjyqtaren e rastit, e cila ka pohuar se është informuar me shkresë nga drejtoria e Katastrit, për mosveprim te tyre në lidhje me kërkesën e gjykatës.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

24. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21 thekson: “*Republika e Kosovës mbrojn dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, [...].*”
25. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, përcaktohet me nenin 31.1 të Kushtetutës: “*Çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedure para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike*”.
26. Po ashtu, Mbrojtja gjyqësore e të drejtave, në nenin 54 të Kushtetutës, përcakton: “*Çdo kush gjëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose më ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur*”.
27. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) është dokument ligjor i zbatueshëm drejtpërdrejtë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.¹ Neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ garanton që: “*Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njëri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm kohor.*”
28. Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199, në nenin 7 par. 2 përcakton: “*Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedure e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor*”.
29. Ndërsa neni 7, paragrafi 5, i Ligjit për Gjykatat nr. 03/L-199, përcakton: “*Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruuar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve*”.
30. Ligji për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, në nenin 10, par. 1 të këtij ligji përcakton: “*Gjykata ka për detyrë të përpinqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të të drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji*”.

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22

Analiza ligjore

31. Ankuesja, ankohet për zvarritje të procedurës në Gjykatën Themelore në Prizren. Ajo konsideron se kjo gjykatë nuk i ka zhvilluar procedurat brenda një afati të arsyeshëm kohor, që sipas saj përbën shkelje të së drejtës së saj për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ, i cili thotë:
- “Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile [...], çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm [...]”*
32. Në raste të shumta, Gjykata Evropiane për te Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se drejta e palës që çështja e tij/saj, të vendoset në afat të arsyeshëm kohor, paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
33. Avokati i Popullit përkujton që, praktika e GJEDNJ ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih aktgjykimin *Moldovan* dhe të tjerët kundër *Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin, *Sienkiewicy* kundër *Polonisë*, më 30 shtator 2003), deri në kohën kur çështja ka përfunduar ose aktgjyki është ekzekutuar, (shih aktgjykimin *Poitier* kundër *Francës*, më 8 nëntor 2005). Megjithatë, Avokati i Popullit përkujton se neni 6 i Konventës nuk e përcakton ndonjë afat absolut të caktuar për përcaktimin e zgjatjes së arsyeshme të procedurës por një përcaktim i tillë varet rrethanat e veçanta të çështjes.
34. Avokati i Popullit vëren se GJEDNJ, në rastin Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës, ka theksuar se një prej faktorëve që duhet të merret në konsiderim është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative, dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre brenda një kohe të arsyeshme (*Aktgjykim Zimmerman dhe Steiner* kundër Zvicrës, 13 korrik 1983).
35. Po ashtu, Avokati i Popullit vëren se, sipas praktikës së GJEDNJ-së, “arsyeshmëria” e kohëzgjatjes se procedurave duhet të vlerësohet... duke ju referuar kriterieve si në vijim: ndërlikueshmëria e rastit, sjelljet e aplikuesit dhe të autoriteteve përkatëse dhe se çfarë ishte në interes për aplikuesin për çështjen në fjalë” (GJEDNJ [Dhoma e Madhe], *Frydlender v. France*, Aplikimi Nr. 30979/96 (2000), par. 43, duke cituar GJEDNJ [Dhoma e Madhe], *Comingersoll S.A v. Portugal*, Aplikimi Nr. 35382/97, par. 19 (2000), par. 19).
36. Prandaj, në rastin në fjalë, Avokati i Popullit rithekson se, periudha përkatëse për t'u shqyrtuar lënda e ankuesit fillon prej viti 2000, kur është iniciuar padia në ish Gjykatën Komunale në Prizren (tani Gjykata Themelore). Pasi ende nuk është marrë vendim përfundimtar lidhur me rastin, data e fundit e hetimit të këtij rasti në shqyrtim, konsiderohet data e publikimit të këtij reporti. Prandaj, Avokati i Popullit konstaton se, pa marrë parasysh pohimet e gjykatës për ndërlikueshmërinë e rastit, gjykata ka dështuar që të gjejë zgjidhje. Vërehet se procedurat gjyqësore kanë zgjatur mbi 17 vite, prandaj Avokati i Popullit konstaton se shkelje të nenit 6 të KEDNJ.

37. Gjithashtu, *ankuesja* pretendon se mungesa e mjeteve efektive në shkeljen e të drejtës për proces te rregullt brenda një kohe të arsyeshme, siç është garantuar me nenin 6 të KEDNJ, përbën shkelje të nenit 13 të Konventës, i cili thotë:

“Çdo person, të cilat kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura me këtë Konventë, ka të drejtë të parafosë një ankam efektiv përparrë një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë e kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare”.

38. Sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit përkujton se GJEDNJ disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë lidhur me palët kontestuese të cilat nuk kanë mjetë për ankesë brenda sistemit të brendshëm vendor, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit (shih aktgjykimin në ratsin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999, dhe aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999). Avokati i Popullit, gjithashtu përkujton se edhe pse GJEDNJ, ka vendosur se mjetet efektive do të duhej të interpretohen në atë mënyrë që të kuptohet se mjetet mund të jenë efektive në kuptim të spektrit të kufizuar të një mjeti efektiv brenda një konteksti të veçantë (aktgjykimi në rastin *Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, më 6 shtator 1978), GJEDNJ, gjithashtu ka vendosur edhe si vijon:

*“Për sa i përket dështimit të pohuar për të sigruar seance gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm [...] asnjë kualifikim i tillë i përmbajtur në fushën e nenit 13 nuk mund të dallohet. Në të kundërtën, vendi i nenit 13 në skemën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të paraparë me Konventë do të përkrahet mbajten në minimum të kufizimeve të nënkuarta me nenin 13 (aktgjykimi në rastin *Kudla kundër Polonisë*, më 26 tetor 2000)”.*

39. Në vend të kësaj, neni 13 pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që fillimisht dhe në mënyrë primare të mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor duke vendosur me këtë rast një garanci shtesë për një individ për të sigruar që ai apo ajo gëzon të drejtat në mënyrë efektive. Nëse shikohet nga kjo perspektivë, e drejta e një individi për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efikase nëse nuk ekziston mundësia që së pari ta parashtrojë këtë ankesë pranë një autoriteti vendor. Kërkesat e nenit 13 përkrahin ato të nenit 6 (shih aktgjykimi i lartpërmendur *Kudla*). Kështu, neni 13 garanton një mjet ankimi efektiv pranë një autoriteti vendor për një shkelje të pohuar të kërkesave të nenit 6 për ta shqyrtauar një rast brenda një kohe të arsyeshme. Pasi që rasti në fjalë ka të bëjë me ankesën për zgjatje te procedurës, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm.

40. Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit përkujton se efekti i këtij nenit është që të kërkojë që një dispozitë e një mjeti vendor të merret me substancën e “një ankesë të kontestueshme” sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih, p.sh. aktgjykimi në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet te jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih, p.sh. aktgjykimi në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000). Lidhur me ankesën për zvarritje te procedurës, Avokati i Popullit përkujton se “mjetet efektive” në kuptim te nenit 13 do të duhej që ose të kishin qenë në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar ose vazhdimin e saj, ose për të ofruar

përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih, aktgjykimi i lartpërmendur *Kudla*).

41. Avokati i Popullit vëren se, megjithëse çështja është ngritur disa herë pranë autoriteteve kompetente legislative, megjithatë asnjë mënyrë specifike ligjore nuk ka ekzistuar në çështjen në fjalë, përmes së cilës do të kishte mundur të ankohet për zvarritje të procedurës me çfarëdo parashikimi apo shprese për ta arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit.

Konstatimet e Avokatit të Popullit

Nisur nga analiza e informatave, dëshmive dhe fakteve në dispozicion, Avokati i Popullit konstaton se për shkak të zvarritjes procedurale:

- ka shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm kohor, të garantuar me aktet ligjore të lartpërmendura në çështjen në fjalë; dhe
- ka shkelje të së drejtës për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave.

Prandaj, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “[...] *Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore*”, dhe nenin 16, paragrafi 8 të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit “*Avokati i Popullit mund të jap rekomandime të përgjithshme përfunksionimin e sistemit gjyqësorë. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurës*”, bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës

REKOMANDON

Gjykatën Themelore në Prizren

- *Që pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmerr të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C.nr 450/2009.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkeseve të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkua të pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkessë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për

veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Hilmi Jashari
Avokat i Popullit